



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA**



**KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË/KOSOVO POLJE**

**Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale  
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjarë “Dr. Fatmir Krasniqi”**

**NJOFTIM**

Të nderuar qytetarë të Komunës së Fushë-Kosovës,

Në kuadër të luftës kundër pandemisë COVID-19 Ministria e Shëndetësisë ka hartuar Planin Shtetëror për Vaksinim kundër COVID-19. Sipas këtij plani vaksinimi i banorëve të vendit tonë do të realizohet në disa faza.

Vaksinimi i banorëve të komunës së Fushë-Kosovës është obligim i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Fatmir Krasniqi”.

Në funksion të realizimit të këtij procesi ne duhet të bëjmë regjistrimin e kategorive të caktuara të popullatës:

- Punëtorët shëndetësor dhe jo shëndetësor të punësuar në institucionet shëndetësore, publike dhe private, që janë banorë të Komunës së Fushë-Kosovës,
- Banorët e komunës së Fushë-Kosovës të moshës 80 vjeç e më shumë,
- Banorët e komunës së Fushë-Kosovës të moshës 65 vjeç deri në 80 vjeç,
- Pacientët me sëmundje kronike, banorë të komunës së Fushë-Kosovës.

Banorët të cilët iu takojnë këtyre grupeve, për tu regjistruar duhet të paraqiten në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Fushë-Kosovë, në Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) në Bardh të Madh, Sllatinë, Miradi të Poshtme dhe Miradi të Epërme, dhe në Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF) në Vragoli, Fushë-Kosovë dhe Kuzmin.

Po ashtu, regjistrimi mund të bëhet edhe përmes thirrjeve telefonike në numrat e telefonave kontaktues, **045 167 111** dhe **045 167 222**, çdo ditë pune nga ora **08:00** deri **17:00**, duke filluar nga data **17.03.2021**.

Për tu regjistruar duhet të ofrohen këto të dhëna:

- Emri dhe mbiemri
- Mosha
- Vendbanimi
- Numri personal
- Numri i telefonit
- Sëmundjet kronike duhet të dëshmohen me dokumentacion shëndetësor
- Profesioni

Lidhur me procesin e vaksinimit do të informoheni me kohë nga ana e stafit të caktuar të QKMF-së.